



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina

Datë/a:	21.12.2020
Referenc-ë:	
Për/ Za/ To:	Rrezarta Asllani
Përmes/Preko/Through:	Drejtoris së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
Nga/ Od/ From:	Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike Kontrollloi: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit
Tema/ Subjekat/Subject:	Pëlqim

Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ka pranuar kërkesën përmes emailit zyrtar nga Rrezarta Asllani e kërkon shfrytëzimin e hapësirës publike në Sheshin "Zahir Pajaziti" me datë 22Dhjetor 2020.

Qëllimi i aktivitetit është grumbullimi i parave për Nazlije Sherifi e cila ka nevojë për transplantim të veshkës.

Drejtoria pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike nr.01-110-157481, i jep pëlqimin për shfrytëzimin e hapësirës publike me datën 22Dhjetor 2020 në Sheshin "Zahir Pajaziti".

Kushtet e pëlqimit:

- nuk lejohet grumbullimi në hapësirë publike më shumë se pesë(5) persona;
- të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës ;
- varësisht nga vendimet e IKSHP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi.

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.

